

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Revista Newsbomb.al vjen me numrin e ri, nga sot në të gjitha pikat e shitjes! Ja artikujt që do të lexoni
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/revista-newsbombal-vjen-me-numrin-e-ri-nga-sot-ne-te-gjit-ha-pikat-e-s-i401650
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 07:24:50 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 06:38:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	363b1e7282ddb682bd7aa5e08c0d25145359b06a69f9579597c7f029fea5fd11
TEKSTI	4da2032164f9f81f3ba61e20f35ab4fb61398f4c71e3df66deb678f746fc9e22
PAMJA	8b9683233a70527d1384e2da30dca0d0339c21e8b48aa01415e98e6bf3caf082

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	832854e9b79c4a9dc68a773d65e0a956cc47715aac540c4ec8feb916ae3661ee
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b7b490a69c70e21e2941949443c05c93b4bd86b11849ed3235586ee33bac8ed0
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/832854e9b79c4a9dc68a773d65e0a956cc47715aac540c4ec8feb916ae3661ee>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

[Kreu](#)
[Politikë](#)
[Aktualitet](#)
[Ekonomi](#)
[Kulturë & Art](#)
[Rajon](#)
[Sport](#)
[Bota](#)
[Showbiz](#)
[SocialBomb](#)


Çështjet kryesore

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

Aktualitet

20 Shtator 2026, 08:38

Revista Newsbomb.al vjen me numrin e ri, nga sot në të gjitha pikat e shitjes! Ja artikujt që do të lexoni



Shkruar nga Newsbomb



Revista Newsbomb

Revista Newsbomb.al vjen me numrin e gjashtëdhjetë e një, nga sot në të gjitha pikat e shitjes! Po ashtu, mund të abonoheni dhe online, për të gjithë revistën, ose vetëm materialet ekskluzive që ju interesojnë.

Pagat e magjistratëve: A luftohet paligjshmëria me paligjshmëri?! Përplasja mes ekzekutivit dhe drejtësisë për mënyrën e llogaritjes së pagave të magjistratëve ka paralizuar punën në një pjesë të gjykatëve të vendit, ndërsa çështja për neglizhimin e zbatimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese ka përfunduar në Prokurorinë e Posaçme. Por më shumë se sa diskutimi se kush ka të drejtë, disa pyetje themelore vlejnë më shumë: a mund të luftohet shkelja e ligjit me shkelje të tij dhe çfarë duhet të ndodhë me qindra vendime të gjyqësorit të cilat i japin të drejtë qytetarëve të thjeshtë por që nuk zbatohen?! Çfarë ka bërë drejtësia në këto raste kur ka qënë përpara abuzimit të shtetarëve me detyrën? A duhet që luftën gjithmonë ta fitojnë më të fortët?

Heronjtë e zjarrit—Në ato ditë të gushtit, vendi dukej sikur po digjej përpara syve të së gjithëve. Mbi Abazë, Krastë të Krujës, tymi ngrihej shtëllunga-shtëllunga drejt qiellit, dhe

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Bota

A mund ta zhdukë inteligjencën artificiale njerezimin? Skenarët e tmerrshëm dhe mosmarrëveshja e madhe midis ekspertëve



Bota

Alarm në Moskë! Qindra dronë ukrainas godasin Rusinë, flakë në rafineri dhe kaos në aeroporte

Zbulohet më shumë artikuj >

flakët lëviznin nga njëra anë e malit në tjetrën. Ishte data 9 gusht kur zjarri nisi të marrë përmasa dhe për disa ditë nuk u ndal. Banorët jetuan mes alarmit, duke parë nga dritaret se nga po vinte flaka. Disa morën me vete vetëm çfarë mundën dhe u larguan. Natën, shumë prej tyre e kaluan jashtë banesave, me sytë nga kodrat që digjeshin dhe me pasigurinë e frikën në zemër që nuk e dinin se çfarë do të gjenin kur të ktheheshin.

Vettingu, rastet që tronditën Strasburgun–Vettingu i gjyqtarëve dhe prokurorëve ishte një nga shtyllat kryesore dhe njëkohësisht ndër mekanizmat më të debatueshëm të reformës në drejtësi, të miratuar me unanimitet në vitin 2016. Pas përfundimit të tij, bilanci nuk mund të bëhet vetëm përmes numrit të magistratëve të konfirmuar apo të shkarkuar. Një pjesë e rëndësishme e këtij bilanci është tashmë jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg, e cila në një sërë çështjesh ka konstatuar shkelje të Konventës në proceset e rivlerësimit.

Familja ku u bëra Beni–Dikur, filmi shqiptar ishte një familje e madhe. Unë u bëra pjesë e kësaj familjeje në vitin 1975, kur një prej regjisoreve të reja të Kinostudios “Shqipëria e Re”, Xhanfize Keko, më përzgjedhi për të luajtur rolin kryesor në filmin “Beni ecën vetë”. Duke lënë mënjanë gjithë mundimet që pasuan atë përzgjedhje, dua të tregoj disa episode të vogla që, sot, pas 50 vitesh, më dukën shumë të mëdha sepse tregojnë jo vetëm historinë time, por edhe mënyrën se si funksiononte ajo “botë”.

Plasën filmat, po s’kemi skenaristë– Shtatori nis me një lajm të mirë. Festivali Kombëtar i Filmit Shqiptar që kishte 14 vjet pa u bërë, shënoi edicionin e vet të 14-të në një kohë kur në diskutim janë edhe kapituj të ndryshëm të ligjit për kinematografinë. Gjithë filmat që ishin prodhuar me ndihmën e Qendrës Kombëtare të Filmit gjatë këtyre viteve, u bënë bashkë. Unë si gazetarë, u veshja fiks si për në tapetin e kuq të një festivali filmi që do të doja ta shijoja, si aktore. Kisha edhe unë skenarin tim. Aty shihje Ben Blushin, që priste rrezik ndonjë nderim për filmin “Beni ecën vetë”, por Beni nuk kishte ardhur, aktori, se i vërteti ishte aty, duke ecur vetë.

Kur kineastët vuajnë–Kërkesa për më shumë para nga shteti nuk është kërkesa e parë nga producentët dhe kineastët shqiptarë. As më e rëndësishmja, se fundja filmi shqiptar gjithësesi për t’u realizuar do të duhet të kërkojë gjetkë edhe në kompanitë e huaja për t’u realizuar si bashkëprodhim. Por, ndërsa kineastët në botë na vlerësojnë për këtë që është autetnike në vendin tonë, ne vetë përpiqemi të jemi sa më europianë, apo sa më universalë. Mirëpo, herë pas here, ndonjë regjisor si Nolan na përplas ca të vërteta.

Tre festivale filmi në shtator– A duhen kaq shumë festivale filmi, a shkojnë kineastët te njëri tjetri? A ka hatërmbetje? Dhe kush i mbieton ende misionit të vet? Këtë verë nga data 1 qershor e deri më 5 qershor isha në jurinë e medias në “Dea Film Festival”. Ky është një festival që bëhet nga Edmond Topi. Lindi si një ide për të çuar kinemanë aty ku nuk është. Imagjiloni Sarandën. Një vend turistik, si Cannes. Një kinema OPEN AIR. Aty prej 3 dekadash nuk kishte kinema. Ata që kishin lindur aty, pas viteve ‘90, nuk e kishin përjetuar dot kurrë magjinë e kinemasë.

Delvina që duhet të zbuloni! Ka qytete që të presin me një monument të madh dhe të tregojnë menjëherë historinë e tyre. Ka edhe të tjerë që duhen kërkuar më gjatë. Duhet të ecësh në rrugët e tyre, të ngjitesh drejt kodrave, të shohësh rrënojat, kishat e xhamitë, të dëgjosh këngët që kanë mbetur në kujtesën e brezave dhe, mbi të gjitha, të ulesh me njerëzit e tyre për të kuptuar se çfarë e bën një vend të veçantë.

Besmir Veli: Histori, kulturë, tradita, kulinari, natyrë...i gjeni të gjitha këtu në


Delvinë–Besmir Veli, kryetari i bashkisë së Delvinës, është i vështirë për t’u kapur në zyrë për një intervistë. E gjen gjithmonë mes qytetarëve, sa në një fshat në tjetrin. Pastaj rrugës në Tiranë, nëpër zyra ministrish për të kërkuar mbështetje e për të paraqitur projekte për zonën që drejton Delvinën. Por, tani që ka ardhur momenti i një bilanci pune të një mandati të parë, Besmiri ka energjinë për të folur për qytetin, për zonën, për atë që është realizuar në këto 3,5 vitet e para dhe cili është vizioni për vazhdimin.

Savër, në barakat e integritit, ka jetë! Zërat e dhimbjes nuk janë larguar nga ky vend i vogël, ku përveçse rrugës së shtruar dhe disa banesave të reja, çdo gjë tjetër mban mbi vete histori të trishta, historinë e rreth 350 familjeve që u morën me forcë nga shtëpitë e tyre dhe i internuan këtu. Jemi në Savër të Lushnjës, për të risjellë në kujtesë hakmarrjen dhe persekutimin e grave, bijve dhe atyre më të vegjëlvë që u rritën nën formën më diskriminuese që impononte sistemi komunist në Shqipëri, etiketimin armik i pushtetit popullor. Sofokli Kuqeshi sot është 76 vjeç.

Laert Vasili e ka me Dua Lipën: Shqetësohet për mjedisin, por merr shuma të majme projektesh! “Do preferoja thespian si term, jo aktor”. Ndoshta pikërisht këtu nis më mirë portreti i Laert Vasilit në këtë intervistë. Jo tek zhurma që shpesh e shoqëron emrin e tij, jo te debatet jashtë skenës, por te ajo që ai beson se duhet të jetë një artist, një njeri që kërkon, pyet, kundërshton dhe mbi të gjitha, nuk pranon ta jetojë artin si një profesion të shkëputur nga koha dhe shoqëria. Laerti ka kaluar kufijtë e skenës shumë kohë më parë.

Kimia kuqezi–Ai nuk kishte kohë, por momentin e gjeti për të biseduar me mua. Ashtu, me çantën e rrobave të ndërrimit në krah, zëmë një cep dhe ishim gati për të diskutuar. Dukej sikur nuk e zinte vendi. Edhe pse prej pesë ditësh jashtë fushe, energjia me të cilën fliste për revistën Newsbomb ishte për t’u admiruar. Nuk vllite nota madhështie. Përkundrazi, po provonte të ishte pragmatist, sikurse në fushë. “Vëlla, për respekt, se jam për terapi për shkak të dëmtimit”, më tha që në fillim.

Artikujt e plotë mund t’i lexoni në numrin e 61-të të Revistës Newsbomb.al, i cili ka dalë në treg nga sot, datë 20 Shtator dhe mund ta gjeni në të gjitha pikat e shitjes, në të gjithë Shqipërinë. Ju mund të abonoheni dhe online, për të lexuar të gjithë revistën, ose artikujt që ju doni!



Sondazh

Poll


Lexo gjithashtu



🕒 E Diel 07:03

Ulje temperaturash dhe reshje të dendura shiu, zonat ku duhet të keni çadrën me vete





Aktualitet

Prishtina protestoi edhe sot për çlirimtarët, emigrantët u mbledhën në Europë

E Shtunë 22:56



Aktualitet

Protesta kundër vendimit të Hagës për ish-krerët e UÇK "shkon" në SHBA, shqiptarët mbledhen të martën para OKB-së

E Shtunë 22:30



E Shtunë 22:08

"Revolucioni Flamingo" mbyll protestën e 112-të, më 8 tetor mbledhen para Parlamentit kundër reformës territoriale



Aktualitet

Nga Kalabria në të gjitha trevat shqiptare: Arbëreshët dhe shqiptarët bashkohen në një mesazh për Kosovën

E Shtunë 21:39



Aktualitet

Qytetarët e Divjakës nuk heqin dorë, 51 ditë qëndresë kundër propozimit të PS për reformën territoriale

E Shtunë 21:33



E Shtunë 21:20

Mbi 414 kiloigramë kanabis në valixhe e frigoriferë, ARRESTOHET 29-vjeçari shqiptar në Itali



Aktualitet

Fredi Beleri “ngre në pedestal” neo-nazistin e “Agimit të Artë” dhe sulmon drejtësinë greke, “ndërron mendje” pas reagimit të partisë opozitare



Aktualitet

IKMT “zbarkon” në Borsh, “rrëzon poshtë” katër dy katëshe dhe një strukturë plazhi pa leje (VIDEO)

🕒 E Shtunë 19:29

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.